



Prishtinë, 20 dhjetor 2011
Kodi i ZRRE-së: V_386_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore, të datës 27 tetor 2011,

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2011/2012, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B" .

Arsyetim

1. Me datë 27 tetor 2011 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH. A për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore.
 2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh:
 - Të Ardhurat e Lejuara siç janë përcaktuar në dokumentin: Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakova SH.A. – Sezoni i Ngrrohjes 2011/2012; dhe
 - Llogaritjen e detajuar të tarifave siç paraqitet në dokumentin: Përcaktimi i Tarifave për NQ Gjakova SH.A. – Sezoni i Ngrrohjes 2011/2012.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Gjakova SH. A për sezonin e ngrohjes 2011/2012 është dhënë në tabelën e mëposhtme:



**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2011/2012**

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.09 [€/m ² për muaj]	0.12 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.88 [€/m ² për muaj]	1.27 [€/m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.	
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.91 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	58.76 [€/MWh]

III. NQ Gjakova SH.A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.

IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova SH.A. për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Gjakova SH.A. në aplikacionin për tarifa.

V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Enver Halimi, Anëtar